



Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë
Nr. 700 Prot.
Vlorë, më 18/02 /2025



Universiteti i Arteve, Tiranë
Nr. 343 Prot.
Tiranë, më 18/02 /2025

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
DHE
UNIVERSITETIT TË ARTEVE TIRANË**

Nisur nga interesi i përbashkët në zhvillimin e mësimdhënies dhe të kërkimit në të dy universitetet dhe nga përpjekjet për të zgjeruar kontaktet midis universiteteve;

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Aurela Saliaj, Rektor, me poshtë do të njihet si Pala 1, është një institucion publik, që ka statusin juridik, krijuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në **institucionet** e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me adresë: Skelë, Rruga Kosova, Vlorë 9401,

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, ka kompetencë për të marrë pjesë në shërbimet publike në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor dhe krijimin e marrëdhënieve me **institucionet** e tjera akademike, kulturore dhe shkencore, qofshin ato shqiptare apo nga vende të tjera;

Universiteti i Arteve, Tiranë (në vijim UA), përfaqësuar nga Prof. Dr. Erald Bakalli, Rektor, me poshtë do të njihet si Pala 2, është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve, i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 234 datë 23.03.2011, i regjistruar me NIPT K51713024L, me adresë: Sheshi "Nënë Tereza", Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë,

Të dyja së bashku, referuar si Universitetet ose Palët, bien dakord për të nënshkruar këtë marrëveshje bashkëpunimi, sipas klauzolave në vijim:

NENI 1 BAZA LIGJORE

Palët përcaktojnë dhe rregullojnë me këtë marrëveshje hapësirat dhe çështjet e bashkëpunimit të ndërsjelltë, si edhe format dhe mënyrat e zbatimit të saj në mbështetje të, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë si dhe në vecanti me: ligjin Nr. 80/2015 *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*, neni 3, pika 4, germa c.

NENI 2 QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i kësaj marrëveshje është rritja e bashkëpunimit të ndërsjelltë midis Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe Universitetit të Arteve Tiranë, për zhvillimin, shkëmbimin e eksperiencave të përbashkëta si dhe promovimin e punimeve artistike/shkencore të realizuara nga stafi akademik dhe studentët përkatës në fusha të ndryshme.

NENI 3 FUSHAT DHE ÇËSHTJET E BASHKËPUNIMIT

Palët bien dakord të bashkëpunojnë ndërmjet dy Universiteteve në fusha/çështjet si më poshtë:

- a) Shkëmbimin e personelit akademik për procesin mësimor;
- b) Shkëmbimin e pedagogëve, të kërkuesve shkencorë dhe të studentëve në kuadrin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- c) Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese;
- d) Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca artistike, seminare të përbashkëta, si dhe botime në fusha me interes të dyanshëm);
- e) Shkëmbimin e literaturës shkencore;
- f) Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional;
- g) Ngritjen e programeve të përbashkëta të studimit në të gjitha nivelet;
- h) Zhvillimin e programeve të veçanta akademike afatshkurtra.

NENI 4 TË DREJTAT E PALËVE

- a) Të dy Universitetet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme (neni 2, a-h) dhe ndjekja e zbatimit të Marrëveshjes, realizohet nga personi i ngarkuar me urdhër të Rektorit ose Drejtuesit të Njesisë Kryesore, për secilin Universitet.

NENI 5 MËNYRA E REALIZIMIT

Secili Universitet do të caktojë një person ndërlidhës, i cili do të jetë përgjegjës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose programeve specifike.

a) Për Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë:

Person Kontakti: Keida Zahaj
Adresa: Skelë, Rruga Kosova, Vlorë 9401
E-mail: keida.zahaj@univlora.edu.al

b) Për Universitetin e Arteve:

Person Kontakti: Prof. Arian Paço
Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
E-mail: zvrektor.proj@uart.edu.al

NENI 6 PËRGJEGJËSITË E PALËVE

- a) Për secilën nga këto fusha, palët do të diskutojnë e bien dakord rast për rast, duke synuar që të planifikojnë sa më mirë e në terma sa më afatgjatë.
- b) Të bashkëpunojnë për aktivitetet dhe angazhimet reciproke, si dhe arritjen e objektivave specifike.

NENI 7 DETYRIME FINANCIARE

- a) Kjo marrëveshje nuk shkakton detyrime financiare.

NENI 8 SHKAQET MADHORE

- a) Universitetet bien dakord që nëse nuk do jenë të afta të përmbushin detyrimet e tyre, për arsye të grevave ose mosmarrëveshjeve të punës, të çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme shkaktuar përtej mundësisë që kanë Universitetet për t'i kontrolluar, kjo nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.

NENI 9
NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI

- a) Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga data e nënshkrimit.
- b) Marrëveshja rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy Universitetet janë dakord për këtë.
- c) Nëse njëri prej Universiteteve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje, duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë përpara.
- d) Mosrinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Universiteti i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.
- e) Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, firmoset nga Rektorët përkatës.

VLORE, MË 18/01 /2025

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
REKTOR

PROF. DR. AURELA SALIAJ



TIRANË, MË ____/____/2025

UNIVERSITETI I ARTEVE, TIRANË
REKTOR

PROF. DR. ERAJD BAKALLI

